



Planuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivery	08.04.2022	2	viti god year
Organ./Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHK	2010/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOS

A.nr.172/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: Malsore Gashi Bajraktari –kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani -anëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.172/2022 të datës 25.02.2022 të parashtruar nga ankueset

të cilin me autorizim e përfaqëson avokate

Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 08.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.172/2022 e datës 25.02.2022 e parashtruar nga ankuesit dhe

A r s y e t i m

Ankuesit e punësuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, sipas Akte emërimit të datës 21.08.2017 e sistemuar në pozitën “Zyrtare e lartë për skema speciale” në Gjilan, sipas Akte emërimit të datës 01.12.2017 e sistemuar në pozitën “Zyrtar për administrimin e Teknologjisë Informativë”, në Gjilan, ankuesja sipas Akte emërimit të datës 28.12.2018 e sistemuar në pozitën „Zyrtare për Shërbime të Punësimit” në Gjilan, ankuesja

sipas Akte emërimit të datës 01.01.2012 e sistemuar në pozitën “Nëpunëse e Pensioneve dhe Beneficioneve” në Gjilan, dhe sipas Akte emërimit të datës 01.01.2012 e sistemuar në pozitën “Nëpunëse e Pensioneve dhe Beneficioneve” në Gjilan, përmes përfaqësueses së autorizuar me date 10.02.2022 ka parashtruar kërkesë tek Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve për kompensimin e shujtës ditore dhe pagës jubilarë, të cilët me date 16.02.2022 i përgjigjen përmes shkresës me numër protokollit 154 me të cilin e njoftojnë se kjo kërkesë është adresuar gabimisht.

Ankuesit përmes përfaqësuese se autorizuar avokate me datë 25.02.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për mos zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive lidhur me kompensimin e shujtës ditore dhe pagës jubilarë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.03.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa më datë 05.04.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve/Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 172/2022 me numër protokollit 1003/2022 të datës 25.02.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dëshmi nga posta e Kosovës e datës 10.02.2022; Shkresë e datës 09.02.2022; Përgjigje e datës 16.02.2022 në Kërkesë të datës 09.02.2022; Njoftim i datës 22.12.2021; Autorizimi i datës 21.04.2021 prej ½ faqe; Autorizimi i datës 14.09.2021; Përgjigje në ankesë e datës 05.04.2022; Akte emërimit të datës 21.08.2017; Akte emërimit të datës 28.12.2018; Akte emërimit të datës 01.01.2012; Lista e pagave nga data 01.08.2017-31.08.2017; Përgjigje në ankesë e datës 05.04.2022 nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës në Gjilan, me shkresat e bashkangjitura, Akte emërimit të datës 01.12.2017 me përshkrimi i detyrave; Akte emërimit të datës 01.12.2017 për me përshkrimi i detyrave; E-mail i datës 22.02.2022; Lista e pagave nga data 01.09.2017 deri me datë 30.09.2017; Lista e pagave nga data 01.12.2020-31.12.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjes e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesit dhe është

sepse:

Ankuesit nëpërmjet përfaqësueses së tij me autorizim më datë 25.02.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Ministrisë së Infrastrukturës për mos zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive lidhur me kompensimin e shujtës ditore dhe pagës

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të dëshmive të ofruara nga organi i punësimit, konkretisht në baze të listës së pagave ka konstatuar se ankuesit

dhe janë kompensuar për shpërblimin jubilar në muajin gushtë të vitit 2017, ndërsa dhe janë kompensuar për shpërblimin jubilar në muajin shtator 2017. andaj si rrjedhojë Kolegji konstaton se organi i punësimit me rastin e kompensimit ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë respektivisht me nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 ku përcaktohet se: "*Nëpunësit civilë, kanë të drejtat si në vijim: shpërblimi i përvjetorit (jubile)*" si dhe nenin 21 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë ku përcaktohet se: "*Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune*".

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesve se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve nuk respekton Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive lidhur me kompensimin e shujtave dhe pagave jubilarë sipas nenit 52, 53 dhe 54 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, Kolegji ka shqyrtuar bazën ligjore

mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesve dhe dhe si rrjedhojë ka konstatuar së Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014 ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhe jo me shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2018.

Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive pas datës 31.12.2017, andaj mbi këtë bazë, pretendimi ankimor të ankuesve është i pabazuar nga se për të punësuarit në shërbimin civil e vetmja formë për kompensimin e shpërblimit të përvjetorit (jubile) është ajo e përcaktuar me nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 të Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë si dhe me nenin 21 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil. Gjithashtu Kolegji ka marr për bazë edhe nenin 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës ku përcaktohet afati i parashkrimit, citoj „*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”, prandaj kërkesat e ankuesve edhe sikur të jenë të ligjshme janë të parashkruara.

Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.172/2022

Zylo ~~Milaku~~ GOJNOVCI

Procesnjajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare Kolegji

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve Av.
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
- Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë e Punësimit;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

